



Module 2

Barazia Gjinore në Bashkimin European



Co-funded by
the European Union

Pivot

Moduli 2


Barazia Gjinore në Bashkimin European



Co-funded by
the European Union

Tabela e Përmbajtjes

Kapitulli 1: Kuptimi i gjinisë	5
1.1 Fillojmë nga bazat: Çfarë është Gjinia?	5
1.2 Përtej binareve: Kuptimi i diversitetit gjinor	6
1.3 Barazia për të gjithë: Thelbi i Barazisë Gjinore	8
1.4 Identitete të ndërthurura: Rëndësia e ndërthurjes	11
Kapitulli 2: Lëvizjet, perspektivat dhe politikat	14
2.1 Feminizmi dhe barazia gjinore	14
2.2 Ndryshimet e politikave	19
Kapitulli 3: Sfidat, Strategjitë dhe Integrimi	21
3.1 Indeksi i Barazisë Gjinore 2023	21
3.2 Lëvizjet sociale dhe ndryshimet e politikave	25
3.3 Marrëveshja e Gjelbër e BE-së dhe Barazia Gjinore	29
3.4 Përcaktimi i pabarazisë gjinore në fushat e politikave	31
3.5 Rasti i Spanjës	34
Kapitulli 4: Prioritetet aktuale të politikave dhe angazhimi i të rinjve	37
4.1 Një Strategji e BE-së për Rininë	37
4.2 Programet dhe iniciativat specifike	40
A e dinit? Mësoni më shumë në 30 sekonda	41
Koncepte dhe përkufizime interesante	41
Aktivitete	45
Aktiviteti 1: Debat me role mbi ndërthurjen	45
Aktiviteti 2: Kafeneja botërore e barazisë gjinore	46
Referenca	47





Prezantimi

Ne synojmë të përmirësojmë të kuptuarit tuaj për barazinë gjinore, çelësi për ndërtimin e komuniteteve të barabarta, të shëndetshme dhe të lulëzuara. Ky modul trajton aspektet thelbësore të barazisë gjinore, duke përfshirë përkufizimin, rëndësinë dhe efektet e pabarazisë. Ne do të eksplorojmë ndërthurjen, ndikimin e feminizmit dhe sfidat historike dhe aktuale ndaj barazisë gjinore nëpër rajone të ndryshme, si Bashkimi Europian dhe Spanja.

Për më tepër, ne do të shqyrtojmë Indeksin e Barazisë Gjinore, rolin e lëvizjeve sociale dhe ndryshimet e politikave, dhe se si Marrëveshja e Gjelbër e BE-së ndërthuret me barazinë gjinore. Duke mbuluar pabarazinë gjinore në fusha të ndryshme politikash, prioritetet aktuale të politikave dhe angazhimin e të rinjve, ky modul ofron njohuri gjithëpërfshirëse dhe fakte të shpejta për të zgjeruar të kuptuarit tuaj.

Përpara se të fillojmë, merrni një moment për një kuiz të shpejtë për të vlerësuar njohuritë tuaja aktuale dhe për t'ju bërë të mendoni për çështjet në fjalë. A jeni gati të na bashkoheni në këtë rrugëtim drejt një bote më të barabartë dhe gjithëpërfshirëse? Le të fillojmë me kuizin!

<https://forms.gle/mmWB37u45VGsqTi18>

Kapitulli 1

Kuptimi i gjinisë



Bazat e para:

Çfarë është Gjinia?

Gjinia i referohet roleve, sjelljeve, shprehjeve dhe identiteteve që shoqëria u cakton vajzave, grave, djemve, burrave dhe atyre me identitete të ndryshme gjinore. Është më shumë se vetëm mashkull apo femër; ai përfshin një spektër identitetesh që mund të ndryshojnë ndërsa njerëzit rriten dhe shoqëria ndryshon.

Këto aspekte ndikohen thellësisht nga normat kulturore dhe shoqërore, që do të thotë se çfarë pritet në një kulturë mund të ndryshojë në një tjetër dhe këto pritshmëri mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Gjinia ndikon në mënyrën se si individët e shohin veten e tyre dhe se si ata shihen nga të tjerët, duke formuar ndërveprimet, rolet që individët luajnë dhe aksesin e tyre në pushtet dhe në burime brenda komunitetit. Në thelb, gjinia ka të bëjë me mënyrat komplekse se si njerëzit përjetojnë dhe shprehin identitetin e tyre në përputhje me pritshmëritë e vendosura ndaj tyre nga shoqëria.

1.2 Përtej binareve:

Kuptimi i diversitetit gjinor

A keni menduar ndonjëherë për opsionet e identifikimit "mashkull" ose "femër" në formularë dhe keni pyetur veten pse këto janë opsionet e vetme? Gjinia nuk është thjesht një rrugë me dy drejtime; është një rrjet i gjerë rrugësh, ku secila përfaqëson përvoja dhe identitete të ndryshme. Le të zhytemi në diversitetin gjinor, duke shkuar përtej kategorive tradicionale të meshkujve dhe femrave për të njohur shumëllojshmërinë e gjerë të identiteteve gjinore.

Perspektiva binare

Historikisht, shoqëria i ka vendosur njerëzit në dy kategori, meshkuj dhe femra, bazuar në karakteristikat fizike në lindje. Kjo pamje binare e thjeshton gjininë në dy role, duke anashkaluar kompleksitetin e identitetit individual. Megjithatë, kjo perspektivë kap vetëm një pjesë të spektrit të përvojës njerëzore.

Gjinia si spektër

Ndryshe nga modeli binar, perceptimi i gjinisë si një spektër na lejon të njohim dhe vërtetojmë një gamë të gjerë identitetesh gjinore. Këtu janë disa terma kyç që tregojnë këtë diversitet:

Jo-binare

Individët që identifikohen si jo-binare nuk përshtaten mirë në 'mashkull' ose 'femër'. Ata mund të mishërojnë cilësitë e të dyjave, ose të përcaktojnë gjininë e tyre në terma krejtësisht të ndryshëm.

Genderqueer

Ngjashëm me jo-binaret, njerëzi të tillë sfidojnë dallimet tradicionale gjinore, duke shprehur shpesh identitetin e tyre në mënyra që nuk përputhen me normat tradicionale të meshkujve apo femrave.

Gjini fluide

Për individët me gjini fluide, identiteti gjinor mund të ndryshojë me kalimin e kohës. Ata mund të ndihen më të lidhur me të qenit mashkull, femër ose një gjini tjetër në periudha të ndryshme.

Pa-Gjinia

Disa njerëz ndjejnë mungesë gjinie, duke u identifikuar as si mashkull as femër. Kjo mungesë e identifikimit gjinor quhet pa-gjini.

Bigjinor

Një person bi identifikohet me dy gjini, ose njëkohësisht ose duke u luhatur midis tyre.

Dy-Shpirt (Two-spirit)

Ky term është specifik për disa kultura indigjene të Amerikës së Veriut, duke përshkruar një person që mishëron cilësitë e të dy gjinive të njohura tradicionalisht. Është një kujtesë e të kuptuarit të larmishëm të roleve gjinore nëpër kultura të ndryshme.

Përqafimi i diversitetit gjinor është thelbësor për krijimin e një shoqërie ku të gjithë ndihen të respektuar dhe të rëndësishëm. Të kuptuarit e këtyre koncepteve ka të bëjë më shumë sesa thjesht terminologji; ka të bëjë me njohjen e përvojave dhe identiteteve unike të individëve. Na sfidon të mendojmë përtej supozimeve tona dhe të krijojmë hapësira gjithëpërfshirëse dhe mikpritëse për të gjithë.

Ndërsa ecim përpara, le të kujtojmë se gjinia është një aspekt personal dhe kompleks i asaj që ne jemi. Njohja e spektrit të identiteteve gjinore na ndihmon të vlerësojmë pasurinë e diversitetit njerëzor dhe inkurajon një botë më empatike dhe gjithëpërfshirëse.

1.3 Barazi për të gjithë: Bazat e Barazisë Gjimore

Çfarë është

BARAZIA GJINORE?

Barazia gjinore i referohet shpërndarjes së barabartë të të **drejtave, përgjegjësive dhe mundësive** ndërmjet të gjitha gjinive, duke siguruar që qasja e individëve në këto aspekte të mos përcaktohet nga gjinia e tyre në lindje. Barazia gjinore përfshin një angazhim për të siguruar që si gratë dhe burrat, ashtu edhe vajzat e djemtë, **të përjetojnë të njëjtën shkallë lirie për të ndjekur zhvillimin personal, të bëjnë zgjedhje pa kufizimet e roleve strikte gjinore dhe të kenë pozitë të barabartë në shoqëri.**

Ky koncept thekson rëndësinë e krijimit të një kuadri shoqëror ku **gjinia nuk dikton aftësitë, potencialin apo vlerën e dikujt**, duke advokuar për trajtim të balancuar dhe të drejtë të të gjithë individëve, pavarësisht nga gjinia.

Pse na duhet?

Barazia gjinore është themelore për krijimin e shoqërive më të sigurt, më të shëndetshme dhe më të begata. Duke promovuar barazinë gjinore, ne kontribuojmë drejtpërdrejt në parandalimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave, duke trajtuar një çështje kritike që prek miliona njerëz në mbarë botën. Për më tepër, barazia gjinore është e lidhur thelbësisht me përparimin ekonomik. Kur grave dhe burrave u ofrohen mundësi të barabarta për të kontribuar në fuqinë punëtore, për të ndjekur arsimin dhe për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse, ekonomitë bëhen më të fuqishme dhe të qëndrueshme. Shoqëritë që përqafojnë barazinë gjinore si vlerë thelbësore priren të jenë më të sigurt dhe të shfaqin nivele më të larta të shëndetit dhe mirëqenies mes qytetarëve të tyre.

Pabarazia na prek të gjithëve

Pabarazia, e rrënjosur thellë në normat gjinore, na prek të gjithëve, duke i endur fijet e saj në aspekte të ndryshme të jetës dhe shoqërisë. Gratë shpesh hasin pengesa të rëndësishme me të cilat burrat mund të mos përballen në të njëjtën shkallë, si pabarazitë në paga, një pjesë jo e barabartë e punës së papaguar shtëpiake, ekspozimi ndaj dhunës dhe nënpërfaqësimi në rolet drejtuese dhe pozitat publike. Këto sfida janë tregues të pabarazisë së përhapur gjinore.

Për më tepër, individët që identifikojnë ose shprehin gjininë e tyre jashtë normave tradicionale binare përballen me diskriminim, përjashtim dhe ngacmim. Një refuzim i tillë shoqëror jo vetëm që pengon pjesëmarrjen e tyre në jetën e komunitetit, por gjithashtu mund të çojë në rezultate jo të mira shëndetësore, paqëndrueshmëri financiare dhe izolim social.

Burrat dhe djemtë, të detyruar nga pritshmëritë e shoqërisë për të treguar gjithnjë një maskuliniteti (maskilizëm) të ngurtë që vlerëson forcën, stoicizmin emocional, dominimin dhe agresionin, vuajnë gjithashtu. Këto presione rrezikojnë mirëqenien e tyre fizike dhe mendore. Pavarësisht nga një prevalencë më e lartë e çështjeve të shëndetit mendor midis grave dhe vajzave, **burrat kanë më pak gjasa të kërkojnë ndihmë për shkak të stigmës që lidhet me të qenit vulnerabël.** Në vendin e punës, burrat mund të ndihen të penguar nga sfidat me normat e vjetruara gjinore ose përqaqimi i politikave të krijuara për ekuilibrin punë-jetë, të tilla si orari fleksibël i punës ose leja prindërore.

Përkufizimet e ngulitura të maskulinitetit kontribuojnë në vazhdimësinë e dhunës ndaj grave dhe individëve të ndryshëm gjinor. Për të zhbërë këto stereotipe të dëmshme, është e domosdoshme që djemtë dhe burrat të angazhohen në mënyrë aktive në kërkimin e barazisë gjinore, duke i inkurajuar ata të sfidojnë këto norma dhe të mbështesin një kulturë barazie dhe respekti.

Barazia e vërtetë gjinore premtion shumë përfitime për shoqërinë - **ajo nxit një komunitet më të sigurt, më të shëndetshëm dhe më të bashkuar, ku çdo individ, pavarësisht nga gjinia, mund të lulëzojë.**

Rruga drejt barazisë kërkon një **përpjekje kolektive** për të njohur dhe trajtuar ndikimet e ndryshme të pabarazisë gjinore, duke siguruar që çdo person të ketë mundësinë të jetojë i lirë dhe në maksimum, i papenguar nga diskriminimi ose pritshmëritë me bazë gjinore.



1.4 Identitete të kryqëzuara:

Rëndësia e

NDËRTHURJES

Çfarë është ajo?

Ndërthurja (Intersectionality) përshkruan se si sistemet e pabarazisë bazuar në gjini, racë, etni, orientim seksual, identitet gjinor, aftësi të kufizuara, klasë dhe forma të tjera të diskriminimit "ndërthuren" për të krijuar dinamika dhe efekte unike.

Është si ta shikojmë botën përmes një palë syzeve të veçanta që na ndihmojnë të shohim se si pjesë të ndryshme të identitetit tonë – si gjinia, ngjyra e lëkurës, kush na pëlqen, nëse kemi aftësi të kufizuara dhe sa para ka familja jonë – punojnë së bashku për të formuar mënyrën se si e përjetojmë jetën. Na tregon se përvojat tona nuk janë vetëm për shkak të një pjese të asaj që jemi, por për shkak të mënyrës sesi bashkohen të gjitha këto pjesë.

Shembull

Gjetja e Punës

Konsideroni dy miq, Alex dhe Taylor, të cilët të dy po aplikojnë për punë. Alex është një grua afro-amerikane dhe Taylor është një burrë i bardhë, transgjitor. Alex mund të përballlet me diskriminim për shkak të racës dhe gjinisë së saj, me shumë mundësi dyert e mundësive mbyllen për të edhe kur ajo është mjaftueshëm e kualifikuar. Taylor, nga ana tjetër, mund të hasë paragjykime kundër tij për faktin e të qenë transgjitor, edhe pse ai është po aq i aftë sa kandidatët e tjerë. Përvojat e tyre në gjetjen e një pune janë formuar nga ndërthurjet e racës, identitetit gjinor dhe paragjykimeve që vijnë si shkak i këtyre identiteteve.

Kur është përdorur për herë të parë?

Termi "ndërthurje/intersectionality" u vulos nga Kimberlé Crenshaw, një avokate amerikane për të drejtat civile dhe studiuese kryesore e teorisë kritike të racës, në punimin e saj të vitit 1989 për Forumin Ligjor të Universitetit të Çikagos me titull "Demargjinalizimi i Ndërthurjes së Racës dhe Seksit: Një Afro-Amerikane Feministe, kritike e Doktrinës kundër Diskriminimit, Teorisë Feministe dhe Politikave Antiraciste." Crenshaw e përdori termin për të përshkruar përvojat e grave me ngjyrë që përballen me forma të mbivendosura të diskriminimit që nuk mund të kuptoheshin plotësisht përmes "lenteve" ekskluzive të racës ose gjinisë.

Teoria e ndërthurjes i ka rrënjët në lëvizjen feministe afro-amerikane dhe lëvizjeve të tjera të drejtësisë sociale që theksuan ndërveprimin kompleks të racës, gjinisë dhe kategorive të tjera shoqërore.



1. Identitete shumëdimensionale

Ne nuk jemi vetëm një gjë. Raca, gjinia, klasa, seksualiteti dhe aspekte të tjera të identitetit tuaj nuk ekzistojnë të izoluar - ato ndërveprojnë dhe ndikojnë në përvojat tuaja dhe mënyrën se si ju percepton bota.



2. Shtypjet e ndërlikura

Sistemet e ndryshme të shtypjes, si racizmi, seksizmi dhe aftësia, nuk janë çështje të ndara. Ato janë të ndërthurura, duke prekur njerëzit në mënyra komplekse dhe të ndërlikuara.



3. Gjithëpërfshirja është çelësi

Progresi aktual në drejtësinë dhe politikat sociale arrihet nëse dëgjoher zëri i atyre që jetojnë në kryqëzimet e identiteteve të shumta, duke siguruar që nga politikat dhe veprimet të mos përfitojnë vetëm ata me më shumë privilegje.



4. Eksperienca unike

Ndërthurja zbulon se njerëzit me identitete të mbivendosura të marginalizuara përballen me sfida unike që nuk mund të kuptohen plotësisht duke shqyrtuar veçmas aspekte të veçanta të identitetit të tyre.



5. Sistemet e pushtetit

Njohja dhe sfida e vazhdueshme ndaj strukturave historike dhe sistematike të pushtetit që mbajnë në lojë pabarazinë është thelbësore. Kjo do të thotë të shikosh tabllo të madhe, të kuptosh se si funksionojnë shoqëritë dhe kush përfiton nga ato.




6. Fluiditeti dhe ndryshimi

Identitetet dhe mënyra se si ato ndërthuren mund të ndryshojnë me kalimin e kohës dhe në kontekste të ndryshme. Ndërthurja përshtat natyrën fluide të identiteteve dhe përvojave.



7. Synoni për barazi

Qëllimi përfundimtar është arritja e barazisë, duke pranuar se trajtimi i barabartë nuk do të thotë gjithmonë trajtim i drejtë. Zgjidhjet duhet të përshtaten në lidhje me nevojat dhe sfidat specifike të grupeve të ndryshme.



Kapitulli 2

Lëvizjet, perspektivat dhe politikat



2.1 Feminizmi dhe barazia gjinore

Le të fillojmë me të kuptuarit se çfarë është feminizmi.

Feminizmi është një lëvizje sociale, politike dhe kulturore që krijon dhe mbron të drejta dhe mundësi të barabarta për gratë. Kërkon të përcaktojë dhe sfidojë format e ndryshme të pabarazisë dhe diskriminimit me të cilat përballen gratë bazuar në gjininë e tyre. Feminizmi përfshin një gamë të gjerë teorish dhe praktikash të fokusuara në çështje të tilla si paga e barabartë, të drejtat riprodhuese, ngacmimi seksual, përfaqësimi gjinor në politikë dhe biznes dhe promovimi i të drejtave dhe mirëqenies së grave në mbarë globin. Ndërsa ka valë dhe degë të shumta të feminizmit, secila me fokusin dhe metodologjitë e veta, parimi thelbësor mbetet ndjekja e barazisë gjinore.



Lëvizja feministe shpesh përshkruhet sipas periudhave të ndryshme, ku secila shënon periudha të ndryshme historike me fokuse dhe arritje unike:

Vala e Parë (fund i 19-të deri në fillim të shek të 20-të)

Përqendruar në pabarazitë ligjore, veçanërisht në të drejtën e votës së grave. Kjo lëvizje u zhvillua gjatë epokës së shoqërisë industriale, duke çuar në vendosjen e të drejtës së votës së grave në shumë vende.

Vala e Dytë (1960–1980)

E zgjeroi diskutimin duke përfshirë barazinë në ligj, seksualitet, familje, punë dhe të drejtat riprodhuese. I njohur për sloganin "**personalja është politike**", kjo lëvizje vuri në pah sesi përvojat personale ndikohen nga strukturat politike dhe shoqërore, duke çuar në reforma të mëdha ligjore dhe sociale.

Vala e Tretë (1990–fillimi i viteve 2000)

Një përgjigje ndaj mangësive të hasura gjatë valës së dytë, veçanërisht qasjes së saj ndaj racës, klasës dhe seksualitetit. Kjo valë fokusohet në diversitetin, ndërthurjen dhe sfidën ndaj përkufizimeve tradicionale të feminitetit dhe gjinisë, duke lobuar për një feminizëm më gjithëpërfshirës.

Vala e Katërt (2010–deri tani)

E njohur për vënien e theksit tek **ndërthurja** dhe **përdorimin e internetit dhe mediave sociale për aktivizim**. Trajton ngacmimet seksuale, paragjykimet ndaj figurës trupore, kulturën e përdhunimit dhe vazhdon luftën për barazi. **Lëvizja #MeToo**, që nxorri në pah sulmet dhe ngacmimet seksuale, veçanërisht në vendin e punës, është një aspekt domethënës i kësaj vale.

Çdo valë feminizmi ka kontribuar në progresin e bërë nga gjeneratat e mëparshme, duke iu përshtatur kushteve jetësore në zhvillim e sipër nga jeta e grave. Lëvizja vazhdon të zhvillohet, duke u përballur me sfida të reja dhe duke zgjeruar fushëveprimin e saj për të trajtuar më gjerësisht çështjet e barazisë gjinore dhe drejtësisë.

Miratimi i një qasjeje feministe është thelbësore në luftën drejt barazisë gjinore, sepse ofron një kornizë gjithëpërfshirëse për të kuptuar dhe luftuar format e shumëanshme të diskriminimit dhe pabarazisë me të cilat përballen gratë.



#METOO

Ndjekja e një qasje feministe në luftën për barazi gjinore është jetike për disa arsye:



1. Trajton pabarazinë sistematike:

Feminizmi nxjerr në pah se pabarazia gjinore është sistematike dhe e ngulitur thellë në normat, institucionet dhe strukturat shoqërore. Duke trajtuar këto shkaqe rrënjësore, feminizmi synon të çmontojë barrierat që pengojnë barazinë për të gjitha gjinitë.



2. Promovon ndërthurjen:

Feminizmi, veçanërisht në format e tij më bashkëkohore, thekson rëndësinë e ndërthurjes. Kjo perspektivë njih se si forma të ndryshme të diskriminimit, si ato të bazuara në racë, klasë, seksualitet dhe identitet gjinor, kryqëzohen dhe përforcojnë njëra-tjetrën. Levizja siguron që lufta për barazi gjinore të jetë gjithëpërfshirëse dhe t'u përgjigjet nevojave të personave më të marginalizuarve në shoqëri.



3. Sfidon patriarkatin

Feminizmi përballet drejtpërdrejt me sistemet dhe ideologjitë patriarkale që shpesh i japin përparësi autoritetit mashkullor dhe shtypin gratë dhe gjinitë e tjera. Kur flasim për patriarkatin i referohemi një sistemi shoqëror dhe një strukture së qeverisjes ku burrat mbajnë pushtetin parësor dhe mbizotërojnë në rolet e udhëheqjes politike, autoritetit moral, privilegjit shoqëror dhe kontrollit të pronës. Ky sistem karakterizohet nga prioritizimi i autoritetit dhe vlerave mashkullore në aspekte të ndryshme të jetës, nga njësia familjare deri te normat dhe institucionet më të gjera shoqërore. **Feminizmi lobon për rishpërndarjen e pushtetit në të gjitha gjinitë, duke çuar në shoqëri më të barabarta.**



4. Zgjeron të kuptuarit e çështjeve gjinore

Nga një qasje feministe përfitojnë jo vetëm gratë, por gjithashtu sfidohen stereotipet dhe pritshmëritë e dëmshme të vendosura për të gjitha gjinitë. Inkurajohet një kuptim më i gjerë se si normat gjinore prekin të gjithë, përfshirë burrat dhe promovon koncepte më fluide dhe gjithëpërfshirëse të gjinisë.



5. Nxit rritjen personale dhe shoqërore

Feminizmi mbështet individët në mbrojtjen e të drejtave, autonomisë dhe lirisë për të bërë zgjedhje për jetën e tyre. Kjo mbështetje është thelbësore për zhvillimin personal dhe arritjen e potencialit të dikujt, duke kontribuar në komunitete më të shëndetshme dhe më dinamike.



Nxit ndryshimet sociale

Lëvizja feministe ka qenë vendimtare në arritjen e ndryshimeve të rëndësishme ligjore dhe shoqërore që përfitojnë jo vetëm gratë, por edhe shoqërinë në tërësi. Këto përfshijnë të drejtën e votës, të drejtat riprodhuese, mbrojtjen kundër dhunës me bazë gjinore dhe më shumë mundësi të barabarta në arsim dhe punësim.



Krijon politika të barabarta

Një qasje feministe në politikëbërje siguron që legjislacioni të marrë në konsideratë ndikimet e ndryshme mbi secilën gjini, duke çuar në politika më të barabarta dhe efektive. Kjo qasje adreson nevojat dhe sfidat specifike me të cilat përballen gratë dhe gjinitë e marginalizuara në fusha si kujdesi shëndetësor, punësimi dhe arsimi.



Promovon diversitetin dhe përfshirjen

Feminizmi advokon për mjedise që mbështesin diversitetin dhe gjithëpërfshirëse, qoftë në vendin e punës, arsimin apo hapësirat publike. **Vlerësimi i diversitetit çon në shoqëri më të begata, më kreative dhe inovatore.**



2.2 Ndryshimet e politikave



Pak Histori

Themelet para BE-së dhe fazat e hershme (Para

Para se të formohej Bashkimi Europian (BE), vendet europiane kishin ligje dhe praktika të ndryshme në lidhje me barazinë gjinore. Pasojat e Luftës së Dytë Botërore përshpejtuan lëvizjet drejt rindërtimit të rëndësishëm social dhe ekonomik, duke përfshirë rivlerësimin e roleve gjinore.

Traktati i Romës (1957)

Traktati i Romës shënoi themelimin e Komunitetit Ekonomik Europian (EEC), i cili është pararendës i BE-së. Ai prezantoi nenin 119, që detyron pagë të barabartë për punë të barabartë midis burrave dhe grave dhe vendosi kuadrin ligjor themelor për barazinë gjinore brenda BE-së.

Zgjerimi i fushëveprimit dhe legjislacionit (1970-1990)

Gjatë viteve 1970 dhe 1980, Komuniteti Ekonomik Europian (KEE) e zgjeroi fokusin e tij nga paga e barabartë në çështje më të gjera të diskriminimit gjinor. Kjo periudhë prezantoi direktiva për trajtimin e barabartë në punësim, sigurime shoqërore dhe akses në mallra dhe shërbime. Akti Unik Europian i vitit 1986 përfshiu qëllimet e barazisë në objektivat më të gjera të Komunitetit Europian.

Traktati i Matrihtit (1992)

Traktati i Matrihtit ose sic njihet Traktati i Bashkimit Europian transformoi Komunitetin Ekonomik Europian (EEC) në BE dhe futi shtetësinë europiane. Ai përforcoi angazhimet për barazi dhe nisi politika të reja për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e grave.

Traktati i Amsterdamit (1997)

Traktati i Amsterdamit avancoi axhendën e barazisë gjinore duke përfshirë parimin e integritit gjinor, duke kërkuar që perspektivat gjinore të përfshihen në të gjitha politikat dhe veprimet e BE-së.

Karta e të drejtave themelore (2000)

E shpallur në vitin 2000 dhe ligjërish e detyrueshme që nga viti 2009 me Traktatin e Lisbonës, Karta e të Drejtave Themelore të BE-së forcoi angazhimet për barazinë gjinore, duke përfshirë barazinë para ligjit dhe ndalimin e diskriminimit të bazuar në seks.

Strategjia dhe evolucioni i politikave (2000-tani)

BE-ja ka zbatuar strategji dhe plane veprimi të ndryshme për të luftuar diskriminimin gjinor, për të përmirësuar barazinë gjinore dhe për të trajtuar çështje si dhuna me bazë gjinore, hendeku gjinor të pagave dhe nënpërfaqësimi i grave në rolet vendimmarrëse.

Strategjia e Barazisë Gjinore 2020-2025 është përpjekja më e fundit që synon një Europë të barabartë gjinore, duke u fokusuar në luftimin e dhunës me bazë gjinore, sfidimin e stereotipeve dhe sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë në të gjithë shoqërinë.

Sfidat e vazhdueshme dhe drejtimitet e ardhshme

Pavarësisht përparimeve të konsiderueshme, sfidat vazhdojnë, duke përfshirë hendekun gjinor të pagave, nënpërfaqësimin e lidershit dhe shqetësimet në rritje për dhunën me bazë gjinore. BE-ja po ndjek në mënyrë aktive reforma legjislative, programe financimi dhe iniciativa politikash për të kapërcyer këto sfida, me një fokus të shtuar në përfshirjen dhe diversitetin përtej binareve tradicionale gjinore.

Udhëtimi i barazisë gjinore në BE ilustron përkushtimin për ndërtimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe të barabartë, duke theksuar përpjekjet e vazhdueshme për të adresuar pabarazitë historike dhe për t'iu përshtatur sfidave të reja në arritjen e drejtësisë gjinore.

Kapitulli 3

Sfidat, Strategjitë, dhe Integrimi



3.1 Indeksi i Barazisë Gjinore 2023

Vështrim i përgjithshëm

Indeksi i Barazisë Gjinore është një mjet gjithëpërfshirës krahasues i zhvilluar nga Instituti Europian për Barazinë Gjinore (EIGE) për të vlerësuar gjendjen e barazisë gjinore në të gjithë Bashkimin Europian (BE) dhe shtetet e tij anëtare. Ai përcakton barazinë gjinore me pikë që variojnë nga 1 deri në 100, ku rezultati prej 100 përfaqëson barazinë absolute midis grave dhe burrave.

Ky Indeks vlerëson gjashtë fusha kryesore: **punën, paranë, njohurinë, kohën, fuqinë dhe shëndetin**, secila më tej e ndarë në **nën-fusha** për të detajuar çështjet e barazisë gjinore brenda këtyre fushave. Për më tepër, ai shqyrton **dy fusha plotësuese** - dhunën dhe pabarazitë e ndërthurura - megjithëse këto nuk kontribuojnë në rezultatin e përgjithshëm të Indeksit për shkak të fokusit të tyre në grupe specifike.

Në vitin 2023, Indeksi i Barazisë Gjinore shfaqti progresin dhe vështirësitë e BE-së në ndjekjen e barazisë gjinore, duke vënë në dukje një përmirësim modest vjetor, ndërsa theksoi barrën e pabarabartë që krizat u vendosin grave dhe vajzave. Gjetjet gjithashtu vunë në dukje tranzicionin shoqëror sipas **Marrëveshjes së Gjelbër Europiane**, me një vështrim të veçantë në sektorët e energjisë dhe të transportit, duke ilustruar se si nismat mbi barazinë gjinore janë ndërthurur me sfidave dhe pasigurive aktuale.

Ky Indeks luan një rol kyç duke ofruar një matës të prekshëm për barazinë gjinore brenda BE-së, duke lehtësuar krahasimet kohore dhe vendore. Ai informon politikëbërësit, duke identifikuar fushat e progresit dhe duke nënvizuar nevojat për ndërhyrje për të zbutur pabarazitë gjinore. **Raporti i vitit 2023 vuri në dukje një përparim të përgjithshëm të shteteve anëtare, por gjithashtu nënvizoi shkallë të ndryshme progresi**, duke treguar një lëvizje drejt niveleve uniforme të barazisë gjinore krahas boshllëqeve të vazhdueshme që kërkojnë vëmendje. Për shembull, Suedia u shfaq si një shoqëri pothuajse e barabartë gjinore. Për herë të parë, Indeksi i Barazisë Gjinore për BE-në kaloi pragun prej 70 pikësh, duke shënuar një rritje të konsiderueshme prej 1,6 pikësh nga viti 2022 – rritja vjetore më thelbësore që nga fillimi i Indeksit në 2013.

Gjetjet më të fundit nga Indeksi i Barazisë Gjinore 2023

Përparim i përgjithshëm i BE-së

Kalimi i 70 pikëve të Indeksit shënon një rritje historike nga viti në vit, që i atribuohet kryesisht të dhënave të rifreskuara në shtrirjen e kohës—përditësimi i parë i këtij lloji që nga viti 2016. Ky moment historik pasqyron progres të rëndësishëm, me një rritje prej 1.6 pikësh nga 2022, përmirësimi më i madh vjetor që nga viti 2013.

Pabarazitë e vazhdueshme

Pavarësisht përparimeve, Indeksi zbulol pabarazi të qëndrueshme gjinore në fusha të ndryshme. Skenari ekonomik, pjesëmarrja sociale, statusi shëndetësor dhe aksesimi në kujdesin shëndetësor kanë dëshmuar pabarazi në rritje. Megjithatë, ka pasur përmirësime në punën e kujdesit të papaguar, ndarjen dhe cilësinë e punës, pjesëmarrjen në vendimmarrje dhe në arsimim.

Analiza e konvergencës

Periudha nga 2010 deri në 2021 pati një përmirësim të përgjithshëm të barazisë gjinore në të gjithë BE-në, shoqëruar me një reduktim të dallimeve midis shteteve anëtare. Megjithatë, ky trend i konvergencës shfaq ndryshueshmëri ndërmjet vendeve.

Puna

Ndarja gjinore mbetet një sfidë e theksuar në tregun e punës të BE-së, veçanërisht e dukshme midis çifteve me fëmijë dhe individëve beqarë.

Paratë

Shenjat të kthimit pas në kohë në fushën ekonomike në barazinë gjinore shfaqen pas një periudhe stagnante, duke nënvizuar pabarazinë e qëndrueshme të pagave.

Dija - Arsimi

Përparimet të pakta që i atribuohen arritjeve dhe pjesëmarrjes më të lartë, megjithatë ndarja gjinore në arsim vazhdon.

Koha

Vazhdojnë pabarazitë e vazhdueshme gjinore në përkujdesjen dhe aktivitetet sociale të papaguara.

Fuqia

Shtetet anëtare tregojnë progres të pabarabartë drejt vendimmarrjes së barabartë, me inbalancim të vazhdueshëm gjinor në angazhimin politik.

Shëndeti

Përparimi i fushës së shëndetit ka ngecur, me çështje si pirja e tepërt dhe ndikimet shëndetësore të nxehtësisë ekstreme që prekin ndryshe gjinitë.

Dhuna

Të dhënat ekzistuese për dhunën ndaj grave janë të vjetruara dhe nuk e kapin plotësisht thelbin e çështjes.

Fokusi tematik

Indeksi theksoi ndërthurjen e barazisë gjinore dhe tranzicionit të barabartë shoqëror sipas Marrëveshjes së Gjelbër Europiane, duke theksuar rëndësinë e qasjeve të politikave të ndjeshme ndaj gjinisë, veçanërisht në energji dhe transport, për të promovuar një tranzicion të gjelbër të drejtë dhe gjithëpërfshirës.

3.2 Lëvizjet sociale dhe ndryshimet e politikave

BE-ja ka qenë gjithmonë lider në luftën për barazi gjinore. **Gjatë historisë, shumë lëvizje kanë ndihmuar në ndryshimin e ligjeve dhe mënyrën se si njerëzit mendojnë për barazinë gjinore.** Këto përpjekje i kanë bërë vendet e punës, ligjet dhe shoqërinë më të drejta.

Lëvizjet kryesore shoqërore dhe ndikimet e tyre

Lëvizja feministe

Vala dhe ndikimi

Lëvizja feministe në Europë ka evoluar përmes valëve të ndryshme, nga e drejta e votës në fillim të shekullit të 20-të deri te çështjet bashkëkohore si barazia në vendin e punës dhe të **drejtat riprodhuese.**

Impakti në politika

Këto lëvizje nxitën dhe çuan në ligje të rëndësishme për barazinë gjinore, duke përfshirë **Direktivën për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve shtatzëna (92/85/EEC) dhe Direktivën për Barazinë Gjinore (2006/54/EC).**

Lëvizja #MeToo

Vala dhe ndikimi

Me origjinë në vitin 2017, ngriti ndërgjegjësimin global për ngacmimin seksual, veçanërisht në vendin e punës.

Impakti në politika

Nxiti vendet e BE-së të miratojnë ligje më të rrepta kundër ngacmimit seksual, duke ndikuar në propozimin e direktivës së BE-së për të luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje në vitin 2021.

Konventa e Stambollit

Vala dhe ndikimi

Kjo konventë ka nxitur aktivizmin dhe reformën e politikave për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje që nga viti 2011.

Impakti në politika

Inkurajoi vendet e BE-së që të zbatojnë legjislacionin kombëtar gjithëpërfshirës, megjithëse pranimi i tij ndryshon midis shtetet anëtare.

Lëvizja për të Drejtat LGBTQ+

Vala dhe ndikimi

Ka ndikuar shumë në qëndrimet dhe politikat shoqërore për diversitetin gjinor dhe seksual, duke mbrojtur të drejta të tilla si martesat e të njëjtit seks dhe ligjet kundër diskriminimit.

Impakti në politika

BE-ja ka miratuar legjislacionin për të mbrojtur të drejtat e LGBTQ+, duke përfshirë Direktivën për Barazinë e Punësimit (2000/78/EC).

Gratë në STEM

Vala dhe ndikimi

Fokuset në adresimin e pabarazive gjinore në fushat STEM, duke promovuar arsimim të barabartë dhe mundësi karriere.

Impakti në politika

Drejtoi dhe nxiti nisma të BE-së si programi Horizon 2020, që synon barazinë gjinore në kërkim dhe inovacion.

Politikat e BE-së për barazinë gjinore

Traktati i Amsterdami (1997)

U hodhën themelet për trajtim dhe mundësi të barabarta në punësim.

Direktivat për Barazinë Gjinore

Përfshin direktivat për pagë të barabartë, trajtim të barabartë në punësim dhe mbrojtje për punëtorët shtatzëna.

Angazhimet Strategjike

Përfshirë këtu, Strategjinë e Barazisë Gjinore 2020–2025, duke u fokusuar në aspekte të ndryshme si ndalimin e dhunës me bazë gjinore dhe mbyllja e boshllëqeve gjinore në tregun e punës.

Konventa e Stambollit

Tregon përkushtimin e BE-së për të luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje.

Instituti European për Barazinë Gjinore (EIGE)

Forcon promovimin e barazisë gjinore dhe lufton kundër diskriminimit të bazuar në seks.

Direktiva për balancën e punës dhe jetës (2019/1158)

Përmirëson kushtet për prindërit dhe kujdestarët që punojnë.



Plan-Veprimet për të promovuar barazisë dhe përfshirjes

Strategjia e Barazisë Gjinore 2020-2025

Synon fuqizimin e grave dhe promovimin e barazisë në të gjitha fushat e jetës.

Gratë në Digjital

